# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6315
E mërkurë, 19 maj 2021
çmimi 0.40 €


## Lirohen nga akuzat Albulena Haxhiu, Pal Lekaj dhe të tjerët për gazin lotsjellës në Kuvend FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# SERBIA NUK DUHET PRIVILEGJUAR MË FAQE 4-5



Profesori Edward P. Joseph nga Universiteti "Johns Hopkins" në Uashington beson se Bashkimi Evropian duhet të vendosë në mënyrë unanime për çështjen e Kosovës dhe në këtë mënyrë, bashkë me Shtetet e Bashkuara, të fitojë ndikim në krijimin e stabilitetit në Ballkan. Ai në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë" beson se Perëndimi duhet t'i japë fund qasjes privilegjuese që ka ndaj Serbisë për shkak të qëndrimit që ka kjo e fundit ndaj Kosovës. Ai, po ashtu, propozon miratimin e dy parimeve nga blloku evropian dhe NATO-ja përmes të cilave ndalet agresioni politik dhe shmangen ndryshimet territoriale



## GJOSHI: OSMANI PO SHKEL KUSHTETUTËN DUKE IA VJEDHUR PDK-së NJË ANËTAR NË KQZ FAQE 3

## KOSOVA DHE SHQIPËRIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES FAQE 3



## AKTUALE



### SOT MBAHET SEANCA E RADHËS NDAJ THAÇIT, VESELIT, SELIMIT DHE KRASNIQIT F. 2

### KËRKOHET SIGURI MË E MADHE NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR F. 2

### MBI 46 MIJË PERSONA TË VAKSINUAR KUNDËR COVID-19 NË KOSOVË F. 7



## EKONOMI

### KURTI KTHEN NË DETYRË DREJTORIN E ATK-SË QË E SHKARKOI AVDULLAH HOTI F. 9

### KONFIRMOHET AKTAKUZA NDAJ MIMOZA KUSARIT DHE TË TJERËVE NË RASTIN 'HIDROCENTRALET' F. 9



## KULTURË

### VENDIMI I 'EUROPA NOSTRA' PËR MANASTIRIN E DEÇANIT: I PADREJTË DHE I NDIKUAR POLITIKISHT F. 7


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Kurti, Merkelit: Rezultat i dialogut duhet të jetë njohja reciproke

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mbajtur një takim virtual me kancelaren gjermane Angela Merkel, me të cilën, pos të tjerash, ka biseduar edhe për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Sipas një komunikate për media, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, Kurti ka thënë se dialogu me Serbinë "duhet të jetë dialog mes dy palëve të barabarta, që zgjidh kontestet mes dy shteteve e që normalizon marrëdhëniet ndërmjet tyre". Në komunikatë thuhet se Kurti dhe Merkel "u pajtuan që procesi i dialogut duhet të jetë i drejtë" dhe "i ndërtuar mbi mirëbesim" dhe se rezultati i tij "duhet të jetë njohja reciproke". "Pavarësia e Kosovës dhe integriteti i saj territorial nuk mund të jenë temë e bisedimeve dhe nuk mund të kthehemi në kohën para vitit 2008", tha Kurti. Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë pritet të rinisë në qershor.

Kurti dhe Merkeli biseduan edhe për Procesin e Berlinit dhe rëndësinë e tij në nxitjen e bashkëpunimit rajonal. "Në pritje të Samitit të Berlinit, që do të mbahet në fillim të korrikut, kryeministri Kurti theksoi se rajoni ka nevojë për bashkëpunim ekonomik dhe tregtar, por jo për projekte si zëvendësim i BE-së. Ai shtoi se bashkëpunimi ekonomik duhet



të shkojë paralelisht me demokratizimin e rajonit", thuhet në komunikatë. Po sipas saj, Kurti kërkoi nga kancelarja gjermane angazhim për liberalizmin e vizave për popullin e Kosovës, duke thënë se "Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim" dhe se "Gjermania mund të ndihmojë ta shtyjë këtë çështje përpara".

Kancelarja Merkel citohet ta ketë rikonfirmuar mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

# Sot mbahet seanca e radhës ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit

PRISHTINË, 18 MAJM (ER) - Gjykata Speciale ka publikuar agjendën për ditën e sotme (e mërkurë), ku para gjyqtarit të procedurës paraprake do të paraqitën Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqit.

Seanca gjyqësore ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së pritet të fillojë në orën 11:00.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi gjenden në paraburgim në Hagë nga nëntori i vitit 2020.



Katërshja e UÇK-së është duke u akuzuar nga Prokuroria e Gjykatës Speciale për kinse krime lufte.

Mirëpo, ata qysh në seancën e parë gjyqësore patën deklaruar se janë të pafajshëm në raport me akuzat me të cilat është duke i ngarkuar kjo prokurori.

Avokatët mbrojtës disa herë kanë parashtruar kërkesë për mbrojtje në liri të katërshes së UÇK-së, por deri më tani gjyqtari i procedurës paraprake nuk i ka marrë parasysh kërkesat e tyre.

Hashim Thaçi kishte dhënë dorëheqje nga pozita e presidentit ditën (5 nëntor 2020) kur ishte nisur në Hagë.

Një gjë të tillë e kishte bërë edhe Kadri Veseli, i cili kishte dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të PDK-së.

Që nga 5 nëntori i vitit 2020 Kadri Veseli është i vetmi që është lejuar të qëndrojë për disa ditë në Kosovë për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të babait të tij.

# Lirohen nga akuzat Albulena Haxhiu, Pal Lekaj dhe të tjerët për gazin lotsjellës në Kuvend



PRISHTINË, 18 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka liruar nga akuzat për armëmbajtje pa leje, ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, deputetin Pal Lekaj dhe ish-deputetet Donika Kadaj-Bujupi dhe Besa Haxhiu që akuzoheshin për rastin e hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës.

Ata janë liruar nga akuzat në mungesë të provave.

Shpallja e aktgjykimit u bë nga gjykatësja Fatime Dërmaku, e cila tha se në mungesë të provave të akuzuarit lirohen nga akuzat, raporton "Betimi për drejtësi". Sipas kryetares së trupit gjykues, nga administrimi i provave materiale, konkretisht vërtetimi mbi kthimin e sendeve, dokumentacioni dhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, gjykata vlerëson se nuk mund të vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale, pasi që nuk ka asnjë ekspertizë që të mund të vërtetohej fakti se sendet e sekuestruara nuk mund të ishin armë në pajtim me Ligjin për Armët.

## Kërkohet siguri më e madhe në komunikacionin rrugor

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Në kuadër të javës së sigurisë rrugore, të martën vazhduan aktivitetet për javën e sigurisë, të organizuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe AMRKS-në. Aktiviteti ka vazhduar me bartjen e pllakateve nga disa nxënës të shkollave fillore me "Love 30", për t'i sensibilizuar qytetarët se kjo shpejtësi duhet të aplikohet në pjesët urbane afër shkollave dhe qendrave të tjera të frekuentuara.

Për t'u njohur më për së afërmi, me këtë në bashkëpunim me zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës u ndalën disa automjete dhe qytetarëve iu bë me dije kjo si dhe iu shpërndanë maska me logon "Love 30".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kosova dhe Shqipëria nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 18 maj - Në Ministrinë e Mbrojtjes, me nderimet më të larta ushtarake, të martën ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në vizitë zyrtare homologun e tij, ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Niko Peleshi.

Në kuadër të këtij takimi të dy ministrat nënshkruan marrëveshjen e re të bashkëpunimit bilateral në mes të dy ministrive.

Në adresimin para medive, ministri Mehaj ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen vëllazërore të ofruar në të gjitha periudhat e ndërtimit, zhvillimit si dhe në të gjitha të arriturat e deritashme të vendit, sikur edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Në vazhdim ministri Mehaj ka shprehur mirënjohjen e lartë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit shqiptar si vend anëtar i NATO-s në sigurinë e përgjithshme të rajonit dhe më gjerë me pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse.

Ai ka theksuar edhe rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura të saj, duke pasur parasysh përvojën e madhe në procesin e integrimeve euroatlantike dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për ngritjen dhe zhvillimin e operacionalitetit ushtarak në përgjithësi.

Në vazhdim, ministri Mehaj ka njoftuar për përmbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit bilateral dhe fushat kryesore të saj.

Nga ana e tij, ministri Peleshi ka falënderuar për pritjen vëllazërore si dhe për emocionet e impresionet e veçanta të vizitës me këtë rast.

Ai ka përgëzuar ministrin Mehaj për të gjitha të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së, duke konfirmuar angazhimin e




Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e mëtejme të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së si dhe për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike dhe iniciativat rajonale të sigurisë në mënyrë që edhe vendi ynë ta ofrojë kontributin e saj në paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe global.

Ai në vazhdim ka shprehur interesimin e tij për shtimin e angazhimeve për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes dy ministrive dhe ka shprehur zotimin e tij për angazhimin dhe përkushtimin maksimal për ta mbështetur vizionin e ministrit Mehaj në planin politik, diplomatik dhe atë ushtarak për të ardhmen.

Në fund, ministri Peleshi ka ftuar ministrin Mehaj për vizitë zyrtare në Tiranë, me fokus për fuqizimin edhe më tej të përkushtimit dypalësh për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta ndërministrore dhe ndërushtarake.

# Gjoshi: Osmani po shkel Kushtetutën duke ia vjedhur PDK-së një anëtar në KQZ




Prishtinë, 18 maj (ER) - Sekretari elektoral i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Betim Gjoshi, në një konferencë për media ka kritikuar presidenten Vjosa Osmani për mosemërimin e dy përfaqësuesve të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), e cila e ka dërguar çështjen në Gjykatë Kushtetuese për interpretim.

Gjoshi ka theksuar se PDK-ja i është përgjigjur ftesës së presidentes Osmani për t'i nominuar përfaqësuesit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke u mbështetur në të drejtën që i jep Kushtetuta e vendit për t'i emëruar dy përfaqësues në KQZ si grupi i dytë më i madh parlamentar. “Duke iu bindur Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryeministrit Kurtit, zonja Osmani po bën shkelje të Kushtetutës së Kosovës duke i pamundësuar Partisë Demokratike të Kosovës përfaqësimin e dytë në KQZ si dhe duke mos e njohur të drejtën e subjektit politik VAKAT, më i votuari në radhët e subjekteve të komunitetit boshnjak”, ka thënë ai.

Sipas Gjoshit, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti përmes orvatjeve në Gjykatën Kushtetuese po tentojnë t'ia vjedhin PDK-së përfaqësimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që ia ka dhënë Kushtetuta, për t'i bërë vend në KQZ anëtarit të tretë të Vetëvendosjes, që në këtë rast është bashkëpartiakja e Osmanit, Gresa Bytyqi Kelmendi, e cila ka garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit me numrin 80 nga “Lista Guxo”. “Ne jemi të shqetësuar nga faktet e prezantuara në media, që tregojnë se zonja Osmani po shfrytëzon Zyrën e Presidencës për nevoja të subjektit të saj politik, iniciativës qytetare 'Lista Guxo'. Anshmëria politike e presidentes Osmani, duke favorizuar Lëvizjen Vetëvendosje dhe subjektin e saj 'Lista Guxo', është e rrezikshme për demokracinë dhe funksionimin e institucioneve të pavarura kushtetuese. Është shkelje flagrante e Kushtetutës së Kosovës”, ka thënë Gjoshi.



# Serbia nuk duhet privilegjuar më

Profesori Edward P. Joseph nga Universiteti "Johns Hopkins" në Uashington beson se Bashkimi Evropian duhet të vendosë në mënyrë unanime për çështjen e Kosovës dhe në këtë mënyrë, bashkë me Shtetet e Bashkuara, të fitojë ndikim në krijimin e stabilitetit në Ballkan. Ai në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë" beson se Perëndimi duhet t'i japë fund qasjes privilegjuese që ka ndaj Serbisë për shkak të qëndrimit që ka kjo e fundit ndaj Kosovës. Ai, po ashtu, propozon miratimin e dy parimeve nga blloku evropian dhe NATO-ja përmes të cilave ndalet agresioni politik dhe shmangen ndryshimet territoriale

PRISHTINË, 18 MAJ - *Zoti Joseph, në artikullin tuaj të fundit për Qendrën Wilson, ju keni thënë se besoni që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë mungesë ndikimi për ta mbyllur çështjen e Kosovës dhe se ky problem ndikon edhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Ju, po ashtu, keni thënë se korrigjimi i ndasive brenda BE-së ndaj Kosovës është në njëfarë mënyrë çelësi. A mund të flisni më shumë për këtë gjë?*

**Edward P. Joseph:** Është shumë e thjeshtë. Unë, në fakt, besoj se i gjithë ky konfuzion nuk është edhe aq i komplikuar. Ne nuk kemi pasur mundësi ta mbyllim çështjen e Kosovës, dhe kjo gjë lidhet natyrisht me Serbinë, dhe Serbia më pas lidhet, përveçse me Kosovën, edhe me Malin e Zi, Bosnje-Hercegovinën dhe Kroacinë. Kjo gjë lidhet edhe me vetë zhvillimin politik në Serbi. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi lidhet me zhvillimin e saj demokratik, që është duke bërë kthim mbrapa. Dhe krejt kjo lidhet me mungesë të ndikimit. Mungesa e ndikimit që kemi në Kosovë ka të bëjë me atë pse çështja e Kosovës është ende e hapur. Serbia nuk e ka njohur Kosovën, andaj edhe çështja e Kosovës ka mbetur pezull, ashtu sikurse edhe e Serbisë. Serbia nuk ka qenë në gjendje të ecë përpara. Në vend që të ecë përpara, është duke bërë kthim mbrapa. Udhëheqësia e drejtuar nga presidenti Aleksandar Vuçiq është duke bërë kthim mbrapa. Dhe nuk jam vetëm unë që po e them këtë. Kështu po thonë edhe akademikë dhe aktivistë serbë. Dhe krejt kjo ka të bëjë me mungesën tonë të ndikimit.

Përse kemi këtë mungesë? Jo pse Shtetet e Bashkuara nuk janë të fuqishme, në fakt janë shumë të fuqishme apo se Bashkimi Evropian nuk është i fuqishëm, pasi shumë vende brenda tij janë të fuqishme. Problemi është se ne nuk jemi të bashkuar sa i përket çështjes së Kosovës. Për shkak të këtyre ndasive, për shkak të këtyre pesë shteteve të BE-së që nuk njohin Kosovën, kjo i bie që ato pesë vende kanë pozicionin e njëjtë sikurse ai i Serbisë. I bie se ato kanë pozicionin e njëjtë me të Rusisë dhe të Kinës. Kjo i bie që ne jemi të penguar. Nëse pesë shtete të BE-së kanë të njëjtin pozicion sikurse Serbia, Rusia dhe Kina, kjo i bie që Serbia nuk është stimuluar për ta njohur Kosovën, sepse Kosova është e bllokuar nga Rusia dhe Kina. Të imagjinojmë se Rusia dhe Kina do të thonë se nuk do ta njohin kurrë pavarësinë e Kosovës edhe nëse Serbia do ta njohë shtetësinë e saj. Por nëse pesë vendet e BE-së e njohin Kosovën, kjo gjë nuk do të ishte edhe aq problematike dhe aq serioze, pasi Kosova më pas do të mund të ishte pjesë e NATO-s dhe BE-së, dhe kjo bllokadë në Kombet e Bashkuara nuk do të kishte shumë rëndësi. Në këtë mënyrë, Serbia nuk do të kishte kaq shumë ndikim dhe potencialisht do të mund t'i ndalej ritmi, ndërkohë që Kosova do të bëhej anëtare e NATO-s, do të avanconte drejt BE-së dhe do të bëhej shtet më i fuqishëm. Çfarë do të fitonte Serbia përveçse do të shikonte dhe do të humbiste në strategjinë e të mbajturit Kosovën të izoluar. Pra krejt kjo është e lidhur me ndasitë në Evropë, që rrisin më pas ndikimin te Serbia dhe për shkak se Serbia ka ndikim, problemi është i pazgjidhur.

*Ju jeni edhe kritik i Perëndimit kur është fjala për qasjen e tij ndaj Serbisë. Për të qenë më e saktë, ju thoni se "Qeveria më anti-demokratike në rajon dhe partnerja strategjike e Rusisë dhe Kinës - regjimi në Serbi, i udhëhequr nga presidenti Aleksandar Vuçiq - trajtohet në mënyrën më të favorshme".*

**Edward P. Joseph:** Po, plotësisht e saktë, madje është edhe më keq se aq. Ajo çfarë kam thënë është absolutisht e vërtetë dhe ka të bëjë pikërisht me këtë mungesën e ndikimit. Për shkak se kemi këto ndasi, Serbia ka më shumë ndikim. Dhe meqë ajo ka ndikim, ne jemi në pozicion të dobët dhe prandaj na "duhet" Serbia. Neve "na duhet" Serbia më shumë sesa që ne i duhemi asaj. Ne jemi gati se në një pozitë të përgjërimit të saj. Dhe çfarë bëjmë ne? A jemi duke kërkuar llogari nga Serbia rreth përkushtimeve të saj për t'iu




bashkuar BE-së dhe të mbajtur vlerat dhe standardet e BE-së? Jo, nuk jemi. Në vitin kur Serbia ka paraqitur kandidaturën drejt BE-së, Vuçiqi ka dobësuar nivelin e demokracisë në Serbi. Dhe përgjigjen tonë mund ta shihni nëpër deklarimet publike.

Vetëm muajin e kaluar, një politikan i mirënjohur perëndimor, që është publikisht i lidhur me Rusinë dhe Kinën, ka thënë se Serbia është lidere ekonomike dhe politike në rajon. Dhe ne vazhdojmë të mos e mbajmë Serbinë përgjegjëse, e cila ka një qeveri që në thelb nuk është liberale, ndonëse dëshiron ta paraqesë veten si demokratike, por që nuk është e tillë. Nuk zbaton praktika demokratike dhe as ato të BE-së. Ajo promovon vlerat e Rusisë, Kinës dhe Hungarisë, dhe ne ende nuk e mbajmë përgjegjëse, pasi "na duhet" në çështjen e Kosovës.

Kështu edhe jemi përfshirë në çështjen e shkëmbimit të territoreve në kohën e administratës së ish-presidentit amerikan Donald Trump, dhe udhëheqësinë e asaj kohe në krye me Federica Mogherinin. Ne u patëm pajtuar që Kosova të bëjë ndërrim territoresh dhe më pas muajin e kaluar u befasuam kur non-paperi slloven kërkonte që e njëjta të ndodhte në Bosnje-Hercegovinën. Diplomatët më të lartë në ShBA dhe BE kanë qenë duke promovuar konceptin e njëjtë sikurse dokumenti slloven.

*Çështja e ndryshimit të territoreve në Ballkan është duke qarkulluar nga viti 2018. Ju thoni se Uashingtoni dhe Brukseli kanë hequr dorë nga shkëmbimi i territoreve, por kjo temë nuk ka hequr dorë nga këto dy vende. Megjithatë, ju ende përmendni mundësinë që administrata aktuale amerikane të krijojë një standard për të gjashtë vendet që synojnë BE-në, duke theksuar se luftërat në rajon kanë mbaruar.*

**Edward P. Joseph:** Po, kjo është zgjidhja ime. Uashingtoni dhe Brukseli patën thënë se heqim dorë nga tema e shkëmbimit të territoreve. Por muajin e kaluar papritur u prezantua "bomba sllovene" për ndryshime territoriale. Koncepti i njëjtë. Kthehemi prapë te mungesa e ndikimit. Përgjigjja për këtë çështje në teori mund të zgjidhet shpejt. Nëse pesë vendet e BE-së, Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe Qiproja do ta njihnin shtetësinë e Kosovës, ky problem do të zgjidhej menjëherë dhe situata në mes të Kosovës dhe Serbisë do të stabilizohej. Mirëpo e dimë që këto pesë shtete nuk do ta njohin shtetësinë e Kosovës për shkak të problemeve të tyre të brendshme, siç është Katalonja në Spanjë.

Prandaj unë kam gjetur zgjidhje për këtë gjë. Këto vende nuk kanë nevojë që ta njohin Kosovën, por ato vende bashkë me pjesën tjetër të BE-së dhe Shtetet e Bashkuara duhet të krijojnë një pozicion unanim që zbatohet për Kosovën, Serbinë dhe pjesën tjetër të rajonit. Qasja e tyre duhet të jetë drejt dhënies fund të agresionit politik. Ato mund të mos e njohin të gjitha Kosovën dhe kjo mund të jetë në rregull, por ato vende duhet të vendosin limite sepse Serbia është kandidate për anëtarësim në BE dhe Kosova ka Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me bllokun evropian.

Ato më pas mund t'iu tregojnë këtyre vendeve se çfarë duhet të bëjnë, pasi të dyja vendet duan të jenë pjesë e BE-së. Prandaj ato mund të ndalohen në bërjen e luftës përmes mënyrave politike. Në këtë mënyrë, një pozicion unanim i gjithë BE-së nuk mund të injorohet. Serbisë do t'i ndalohet kryerja e fushatës për mosnjohje të shtetësisë së Kosovës, sepse kush është ajo që ta bëjë një gjë të tillë nëse BE-ja dhe ShBA-ja nuk ndalojnë diçka të tillë apo kush është Serbia që t'ia ndalojë Kosovës anëtarësimin në Interpol, nëse fuqitë e mëdha nuk e bëjnë një ndalesë të tillë?

Por, në anën tjetër, edhe Kosova nuk mund të nisë agresion politik kundër Serbisë dhe serbëve në Kosovë dhe të kërcënojë me bashkim me Shqipërinë, duke bërë serbët në Kosovë minoritet edhe më të vogël. Pra kush është Kosova që ta bëjë një gjë të tillë? Kosova nuk mund ta bëjë këtë gjë. Jo nëse dëshiron ta zbatojë MSA-në. Dhe këto veprime nuk janë në linjë me të. Përbëjnë agresion dhe kjo gjë duhet të ndalet.

Kur ky agresion politik të ndalet, gjithçka ndryshon, sepse fuqia e ndikimit bartet. Në situatë të këtillë, kur ndalet fushata e Serbisë për mosnjohje të Kosovës, ky shtet nuk mund ta ndalë Kosovën nga zhvillimi, nga rritja e kapacitetit të saj ndërkombëtar, më pas nuk mund t'ia ndalojë anëtarësimin në BE dhe organizata të tjera apo edhe krijimin e marrëdhënieve me vende të tjera. Serbia më pas ose duhet të negociojë - diçka që duhet të bëjë apo mund ta refuzojë një gjë të tillë. Nëse refuzon, tregon qartë se cila është zgjedhja e saj. Tregon për refuzim të BE-së për dallim nga të pretenduarit kinse po i bashkohet BE-së, ndërkohë që promovon agjendën e Rusisë, Kinës dhe Hungarisë.

*Në artikullin tuaj ju keni përmendur nevojën e hartimit të dy parimeve koncize - një të formalizuar nga BE-ja, dhe tjetrën nga NATO-ja. A mund të na i shpalosni ato më shumë?*

**Edward P. Joseph:** Na duhet ta kujtojmë se për çfarë është gjithë kjo gjë. E gjitha kjo synon që t'i mundësojë BE-së dhe ShBA-së që të mos privilegjojnë më Serbinë, sepse këtë gjë janë duke bërë tani. Meqë nuk kemi ndikim mbi Serbinë, ne privilegjojmë atë. Serbia mund të sillet në mënyrë jodemokratike, mund të jetë aleate me Rusinë dhe Kinën dhe ne të themi "ju jeni lidere". Kjo gjë duhet të marrë fund. Kjo gjë mbaron kur të sillemi me Serbinë sikurse me vendet e tjera. Jo duke e vendosur në një pozicion më të keq, por jo edhe më të mirë sesa të tjerët. Më pas do të mund të kishim dy parime. Njërën nga BE-ja dhe tjetrën nga NATO-ja. Ato janë të hartuara në atë mënyrë që kurrë nuk mund të zbatohen, shembull për Katalonjën. Gjithçka është e hartuar shumë me kujdes dhe lidhet me Serbinë dhe Kosovën, të cilat kanë marrëveshje zyrtare me BE-në. Katalonja nuk mund të përfshihet në këto parime asnjëherë, përveç nëse Qeveria në Madrid miraton diçka të tillë, por ajo nuk do të ndodhë. Parimi i BE-së përcakton që këto dy shtete nuk mund të kryejnë agresion politik kundër njëra-tjetrës. Parimi i NATO-s është shumë specifik dhe lidhet me ndryshime të kufijve. Në këtë rast lidhet me mundësinë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, por ka të bëjë edhe me Bosnje-Hercegovinën. Pra kjo mund të vlejë për të gjitha shtetet. Kjo është ajo që bëjmë këto parime. Ato i mundësojnë BE-së dhe ShBA-së të bëjnë diçka që nuk mund të bëjnë tani, pasi nuk e kanë mbështetjen e të gjitha shteteve, sepse pesë shtetet e BE-së janë të lidhura me Serbinë dhe Rusinë dhe Kinën sa i përket çështjes së Kosovës.

*Ju keni paraqitur edhe mundësinë që ShBA-ja të hartojë një Traktat për Mbrojtje të Ndërsjellë me Kosovën, sikurse atë që ka me Korenë Jugore.*

**Edward P. Joseph:** Ky Traktat është i rëndësishëm për dy arsye, pasi pesë shtetet mosnjohëse të BE-së mund të kundërshtojnë idenë që t'ia ndalojnë Serbisë fushatën për mosnjohje të Kosovës dhe të thonë se Serbia mund të bëjë çfarë të dëshirojë dhe nuk na intereson nëse Rusia dhe Kina shtrijnë ndikimin në Ballkan. Epo nëse ekziston një disponim i tillë, atëherë na duhet rritje e ndikimit aty, po ashtu. Nëse Spanja është e interesuar vetëm për Katalonjën dhe kështu ia mundëson Serbisë që ta vazhdojë kryerjen e agresionit politik dhe ia mundëson ndikimin Rusisë dhe Kinës, atëherë ashtu na shtyn edhe neve të bëjmë disa ndryshime. Kështu ShBA-ja mund të detyrohet të krijojë një marrëveshje bilaterale me Kosovën, për të cilën nuk mund të bëjë asgjë as Spanja, as Serbia, as Rusia dhe as Kina. Dhe nëse ShBA-ja e kthen Kosovën në partnere strategjike, atëherë për Serbinë ndryshon gjithçka. Strategjia e Serbisë në atë rrafsh dështon, ndërsa Kosova fiton siguri gati sikurse të ishte anëtare e NATO-s. Prandaj nëse këto shtete nuk pranojnë propozimin që të mos e njohin Kosovën, madje që as Serbia të mos njohë Kosovën, atëherë kjo gjë e detyron ShBA-në të marrë vendime të tjera, sepse një gjë e tillë nuk mund të tolerohet më.

*Parimet e reja do ta cenonin politikisht presidentin serb Aleksandar Vuçiq. Pse mendoni kështu?*

**Edward P. Joseph:** Kjo është gjë shumë e rëndësishme. Kjo është pyetje shumë e rëndësishme sepse një nga argumentet që përdorin njerëzit që thonë 'ju nuk e kuptoni këtë, sepse nëse e kritikojmë Serbinë për nivelin e demokracisë apo për pozicionin në rajon për dëmtim të Malit të Zi apo Bosnjës, presidenti Vuçiq do të thotë se shikoni, unë jam duke mbrojtur interesat e serbëve në Kosovë, Mal të Zi, Bosnje, apo edhe Kroaci, unë jam duke i mbrojtur dhe për këtë ata më bëjnë presion mua'. Në këtë mënyrë ai mendon se mund të bëjë diçka të tillë dhe opozita të mbetet më e dobët. Por jo me këtë skenar, sepse edhe opozita në Serbi nuk ka pse ta njohë Kosovën. Ata mund të thonë çfarë të duan për Kosovën, por edhe do të mund ta kritikojnë presidentin Vuçiq në një mënyrë që nuk munden tani. Opozita nuk mund ta kritikojë tani Vuçiqin sepse ai ka përkrahjen publike të ShBA-së dhe të BE-së. Ai mund të thotë se shihni se si jam duke ndërhyrë në çështjet e Malit të Zi dhe sërish e kam mbështetjen e BE-së dhe të ShBA-së. Por me skenarin e ri ai nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, sepse opozita mund t'i thotë nuk e ke përkrahjen e ShBA-së dhe BE-së dhe ju jeni fajtor për këtë gjë. Ju e keni bërë këtë.

*Përgjatë tekstit, ju përmendni presidentin serb Vuçiq, por jo edhe liderët e Kosovës. Si e komentoni qasjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në dialogun me Serbinë? Ai ka thënë se ky proces duhet të ketë parime, dhe të dyja palët duhet të jenë të barabarta.*

**Edward P. Joseph:** Nuk është e nevojshme për mua. Pse më duhet mua të flas për liderët e Kosovës? Ata pothuajse nuk kanë fare ndikim. Ata janë në pozicion sekondar. Kosovës i duhet njohja. Nuk ka rëndësi fare çfarë flet Kurti, se dialogu nuk është prioriteti i tij, sepse ky nuk është realiteti. Realiteti është që Kosovës i duhet kjo gjë dhe ai e di mirë këtë. Kosova është në pozicion më të dobët sepse nuk ka ndikim dhe as ne nuk kemi ndikim. Pra nuk është qendër e problemit. Dua t'i referohem Kurtit në deklaratën që ka bërë në muajin shkurt për një të përditshme kroate. Ai hapur ka promovuar idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Ai, po ashtu, ka votuar në zgjedhjet në Shqipëri dhe partia e tij ka garuar në zgjedhjet në Shqipëri. Përmes të gjitha këtyre veprimeve, ai është duke promovuar bashkimin në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe një gjë e tillë është e ndaluar sipas qasjes sime. Partia e tij nuk duhet të garojë në zgjedhjet në Shqipëri dhe ai nuk duhet ta promovojë bashkimin me Shqipërinë. Kjo gjë duhet të ndalohet. Ky është agresion kundër serbëve në Kosovë dhe Serbisë. Albin Kurti është kryeministër i të gjithë qytetarëve, dhe aty përfshihen edhe serbët e Kosovës. Ai nuk mund ta ndryshojë kombësinë e qytetarëve të vet, nuk mund të thotë se 'ju tani jeni qytetarë të Kosovës, por ne do ta ndryshojmë këtë sepse do të jemi konfederatë me Shqipërinë'.

*Mendoj se Kurti së fundmi ka thënë se nuk mund të bëjnë bashkimin me Shqipërinë sepse Kushtetuta e Kosovës nuk e lejon një gjë të tillë.*

**Edward P. Joseph:** Ai e ka thënë këtë gjë edhe në intervistën e tij në shkurt, mirëpo ka thënë edhe se Kushtetuta e Kosovës është e padrejtë. Ai nuk thotë se duhet ta bëjmë bashkimin me Shqipërinë sepse Serbia nuk na lë të anëtarësohemi në NATO dhe kjo është mënyra e vetme për ta bërë një gjë të tillë. Ai nuk e thotë këtë gjë. Ai e thotë arsyen e ngjashme sikurse që ekziston për Serbinë e Madhe. Ai e përmend sesi shqiptarët janë ndarë një shekull më parë. Ky është mentalitet që nuk duhet ta kemi. Kjo nuk i përket shekullit XXI. Kjo është diçka e shekullit XIX. Luftërat kanë mbaruar. Shqiptarët do të jetojnë në Maqedoninë e Veriut, në Kosovën e pavarur, në Malin e Zi dhe Shqipëri, por jo në një shtet të përbashkët.

**(Intervistoi Krenare CUBOLLI / Radio Evropa e Lirë)**

# Sveçla priti në takim ekipet e tri shteteve që morën pjesë në konfiskimin e drogës në Lipjan



PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, ambasadorin e Shqipërisë në Kosovës, Qemal Minxhozi, drejtorin e Policisë, Samedin Mehmeti, si dhe zyrtarët e tri shteteve që morën pjesë në operacionin e suksesshëm të konfiskimit të rreth 400 kilogramë substancave narkotike që u kapën dje në Lipjan.

Pala italiane dhe ajo shqiptare vlerësuan lart bashkëpunimin në mes tre vendeve, që bashkërisht ndalën korridorin e depërtimit të substancave narkotike. “Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë e hapur për bashkëpunime ndërkombëtare të luftimit të çfarëdo krimi. Policia e Kosovës është e gatshme që të marrë pjesë në secilin operacion. Ju garantoj se si qeveri do të jemi të pakompromis në luftimin e të gjitha krimeve, sepse vetëm kështu krijohet një klimë e mirëbesimit të qytetarëve ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit”, ka theksuar ministri Sveçla. Ai ka falënderuar ekipet që morën pjesë në këtë operacion, duke vlerësuar se bashkëpunimi i mirë mes tre shteteve ka sjellë rezultate të jashtëzakonshme në luftimin e krimit transnacional.




## Kërkohet paraburgim për shtatë personat e arrestuar për drogë në Lipjan

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka njoftuar opinionin se sot ka bërë kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për caktimin e paraburgimit të shtatë personave të cilët janë ndaluar më 17 maj 2021 lidhur me aksionin ku janë sekuestruar 400 kg narkotikë të llojit kokainë. “Prokuroria Speciale kërkesën e ka bërë për shkak të dyshimit se të njëjtët kanë kryer veprat penale ‘Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar’ nga neni 277, paragrafi 1 i KPRK-së, lidhur me veprën penale ‘Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge’ nga neni 269, paragrafi 1, lidhur me nenin 275, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.9 të KPRK-së dhe në drejtim të veprës penale ‘Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’ nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së”, thuhet në njoftimin për media.



## Shërbimi Korrektes pranon 49 detektorë statikë nga Ambasada e ShBA-së

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Shërbimi Korrektes i Kosovës ka pranuar donacionin e radhës nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkatësisht nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL). Në këtë donacion janë pranuar 49 detektorë statikë, të cilët do të shërbejnë për kontrollimin e personave gjatë hyrje-daljeve nëpër të gjitha institucionet korrektuese.

Detektorët janë pajisje të avancuara, të cilët do ta lehtësojnë punën e stafit në parandalimin e futjes së mjeteve të rrezikshme brenda institucioneve korrektuese.

Dhurimi i këtij donacioni ka për qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në hyrjet dhe daljet e institucioneve korrektuese, si dhe përmirësimin e kushteve të punës, duke u mundësuar zyrtarëve korrektues që punën e tyre të përditshme ta kryejnë me efikasitet edhe më të lartë.

ICITAP & INL me donacionet e saj po vazhdojnë ta mbështesin fuqishëm zhvillimin e ShKK-së në të gjitha fushat, veçanërisht atë të sigurisë, duke aspiruar në ndërtimin e një sistemi të vetëqëndrueshëm, të pavarur dhe të sigurt.

## Haxhiu dhe ambasadorja e Suedisë diskutuan për sundimin e ligjit

PRISHTINË, 18 MAJ (ER)- Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka zhvilluar të martën një takim me ambasadoren e Suedisë, Karin Hernmack Ahliny dhe zyrtarin politik Olle Ingvarsson. Duke shprehur falënderimet për mbështetjen e vazhdueshme të Suedisë, ministrja Haxhiu i informoi më shumë rreth prioriteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe çështjeve të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit. Në anën tjetër, ambasadorja Karin Hernmack Ahliny vuri theksin te respektimi i të drejtave të njeriut, dhe e njoftoi ministren e Drejtësisë, Haxhiu, lidhur me kontributin e Suedisë në fusha të ndryshme, në veçanti në sundimin e ligjit.

Nga të dyja palët u shpreh vullnet për bashkëpunim me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit.



KOSOVA I REAGON 'EUROPA NOSTRA'-S PËR PËRFSHIRJEN E MANASTIRIT TË DEÇANIT NË LISTËN E MONUMENTEVE MË TË RREZIKUARA NË EVROPË

# Vendimi i 'Europa Nostra' për Manastirin e Deçanit: I padrejtë dhe i ndikuar politikisht

Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i kanë dërguar letër presidentit ekzekutiv të 'Europa Nostra' në lidhje me përfshirjen e Manastirit të Deçanit në listën e monumenteve më të rrezikuara në Evropë. Në letër thuhet se vendimi i 'Europa Nostra' është i padrejtë dhe i ndikuar politikisht



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 18 maj** - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i kanë dërguar letër presidentit ekzekutiv të 'Europa Nostra' në lidhje me përfshirjen e Manastirit të Deçanit në listën e monumenteve më të rrezikuara në Evropë. Në letrën drejtuar presidentit ekzekutiv të Europa Nostra thuhet se vendimi për Manastirin e Deçanit është i padrejtë dhe i ndikuar politikisht. "I nderuar z. Hermann Parzinger, president ekzekutiv i Europa Nostra, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës shprehim shqetësimin tonë për vendimin e Europa Nostra për ta përfshirë Manastirin e Deçanit në listën e 'Shtatë monumenteve më të rrezikuara në Evropë'. Jemi të bindur që ky vendim është i pabazuar pasi nuk përkon me faktet në terren. Për më shumë, vendimi është qartësisht i ndikuar politikisht, një praktikë e paprecedentë në historinë me reputacion të lartë të Europa Nostra. Ne ju ftojmë ta vizitoni Kosovën dhe shihni nga afër gjendjen e Manastirit të Deçanit. Gjatë marrjes së këtij vendimi keni neglizhuar një dimension esencial, konsultimet me palët e interesit, ndërsa keni marrë për bazë një tekst tendencioz dhe joprofesional të organizatës dominuese", thuhet në letër.

Gërvalla e Çeku i kanë bërë thirrje presidentit ekzekutiv të Europa Nostra ta vizitojë Kosovën dhe të bisedojë me banorët e zonës, klerikët e Manastirit, organizatat e shoqërisë civile, profesionistët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, zyrtarët e shtetit dhe të tjerë. "Vizita e delegacionit tuaj në Kosovë propozojmë të realizohet sa më shpejt. Dëmin që ia keni shkaktuar reputacionit të Kosovës me vendimin tuaj të padrejtë dhe të pabazuar duhet ta kompensoni pa vonesë. Jemi të prirë të besojmë që rezultati i vizitës dhe vlerësimit tuaj të gjendjes do të rezultojë me rishikimin e listës tuaj duke e larguar Manastirin e Deçanit", thuhet në letër.

Më tej theksohet se është vlerësim i pavarur dhe profesional i institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të rendit dhe sigurisë që kishat ortodokse në Kosovë gëzojnë nivel të lartë sigurie dhe nuk janë të rrezikuara. Me shpalljen e pavarësisë, shteti i Kosovës ka miratuar të gjitha garancitë kushtetuese, ligjore, institucionale dhe politike për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve joshumicë në vendin tonë. Republika e Kosovës është plotësisht e përkushtuar për mbrojtjen e të gjitha aseteve të trashëgimisë kulturore të vendit, në veçanti të kishave dhe manastireve ortodokse, klerit ortodoks, praktikuesve të fesë e komuniteteve joshumicë. Institucionet e Republikës së Kosovës janë instanca më e lartë e mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore në vend. Ne e mbrojmë trashëgiminë tonë. Trashëgimia jonë është universale, ajo i takon krejt njerëzimit, brezave të kaluar, të tashëm dhe të ardhshëm. Në këtë frymë ju ftojmë për bashkëpunim parimor, me synim mbrojtjen sa më efektive të trashëgimisë kulturore. Jemi kundër instrumentalizimit të trashëgimisë kulturore për përfitimet politike të njërit shtet apo tjetrit", thuhet në letrën e Gërvallës dhe Çekut.

# Në 24 orët e fundit, një i vdekur dhe 64 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 18 maj** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 4 297 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 64 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i të vdekurit me SARS CoV-2 pozitiv. Rasti është nga komuna e Gjilanit, 72 vjeç.

Numri total i rasteve pozitive është 107 003 raste nga 575 614 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2 227 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 409 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 100 233 raste, kurse numri i rasteve aktive është 4 543.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 12 raste, Ferizaj 9 raste, Skenderaj 7 raste, Mitrovicë 6 raste, Prizren 5 raste, Deçan 3 raste, Gjakovë 3 raste, Istog 3 raste, Klinë 3 raste, Malishevë 2 raste, Obiliq 2 raste, Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Fushë-Kosovë, Gjilan, Kamenicë, Pejë, Shtime dhe Suharekë.

Në klinikat Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme, në bazë të raportit të punës për datën 18 maj 2021, janë të shtrirë 271 persona. "157 pacientë janë të konfirmuar me Covid-19, 14 janë në gjendje të rënduar shëndetësore dhe 190 janë nën asistim të oksigjeno-terapisë", ka njoftuar ShSKUK-ja.



## Mbi 46 mijë persona të vaksinuar kundër Covid-19 në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë kryer 4 229 vaksinime kundër koronavirusit, duke e çuar në 46 097 numrin e personave mbi moshën 65 vjeçe që kanë nisur procesin e imunizimit kundër Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusi. "Procesi i vaksinimit për personat mbi 65 vjeç po vazhdon përmes caktimit paraprak të terminëve për qytetarët, të cilët janë regjistruar dhe kanë aplikuar përmes platformës e-Kosova", është thënë në njoftimin për media.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, në ditët në vijim në Kosovë do të arrijnë doza të tjera të vaksinës, por nuk është saktësuar se kur dhe sa doza.

# Konfirmohet aktakuza ndaj Mimoza Kusarit dhe të tjerëve në rastin 'Hidrocentralet'

Është konfirmuar aktakuza ndaj ish-ministrave të qeverisë "Thaçi 2" për rastin e hidrocentraleve, pasi Gjykata e Apelit i ka refuzuar të martën ankesat e avokatëve për hedhjen e aktakuzës ndaj ish-ministrave të qeverisë "Thaçi 2": Mimoza Kusari-Lila, Besim Beqaj, Dardan Gashi, Nenad Rashiq, të cilët akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MAJ - Gjykata e Apelit e Kosovës i ka refuzuar të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave në rastin e të pandehurve Besim Beqaj, Mimoza Kusari-Lila, Dardan Gashi, Nenad Rashiq, Fllanza Hoxha dhe Arben Gjuka. Ata akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare në rastin e njohur si "Afera e hidrocentraleve". "Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 04.03.2021, është vërtetuar dhe çështja penale ndaj tyre do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës penale. Të pandehurit në fjalë po akuzohen nga ana e prokurorit special për veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje' nga neni 422, par. 2, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)", është thënë në njoftimin e Gjykatës së Apelit.

Sipas këtij njoftimi, Gjykata e Apelit po ashtu ka refuzuar edhe ankesën e Prokurorisë Speciale për të akuzuarit e tjerë në këtë rast: L. F., F. H., F. Ç., M. R., A. N., F. K., I. I., G. J., B. B., G. Sh., N. H., A. A. "Procedura penale ndaj tyre është pushuar për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale. Gjykata e Apelit gjeti se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt dhe ligjshëm, duke dhënë arsye të mjaftueshme, kur i ka trajtuar kërkesat e mbrojtësve, për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave", është thënë në njoftimin e Apelit.




# Kurti kthen në detyrë drejtorin e ATK-së që e shkarkoi Avdullah Hoti

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kthyer në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Ilir Murtezaj, të cilin e kishte shkarkuar ish-kryeministri Avdullah Hoti. Përmes një komunikate për media, ATK-ja ka njoftuar se Kurti ka zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka konstatuar se shkarkimi i drejtorit Murtezaj ka qenë i kundërligjshëm dhe të njëjtin e ka kthyer në pozitën që mbante. "Sot drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka rifilluar punën, me ç'rast ka mbajtur takim me menaxhmentin e lartë, në të cilin u diskutuan aktivitetet në vijim, planet dhe objektivat për këtë vit. Bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka konstatuar se shkarkimi i drejtorit Murtezaj ka qenë i kundërligjshëm, kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti, në zbatimin të vendimit të KPMSHCK-së më datë 17 maj 2021, ka marrë vendim për kthim të menjëhershëm të Ilir Murtezajt në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës", thuhet në komunikatën për media.



Në takimin e mbajtur me menaxhmentin e lartë, drejtori Murtezaj ka deklaruar se do të vazhdojë që të punojë me përkushtim me punët ku kanë mbetur. "Prioritetet dhe objektivat e ATK-së do të kenë jetësim nëse secili prej nesh do të punojë me profesionalizëm dhe dinjitet", ka thënë Murtezaj.

Po ashtu, ai ka thënë se janë dëshmitarë që ATK-ja sikurse çdo institucion tjetër është duke u përballur me pasojat e pandemisë Covid-19, mirëpo ka theksuar se do t'i rimarrin prapë proceset që të ecet përpara.

Drejtori Murtezaj në fund të këtij takimi ka potencuar se shteti ynë më shumë se kurrë ka nevojë të fuqizohet, ku të gjithë së bashku duhet të punojmë, përfshirë këtu bashkëpunimin institucional dhe ndërinstitucional, partnerët dhe tatimpaguesit.

# Deputetët kërkojnë dokumente shtesë për kryetar dhe anëtarë të Bordit të ARKEP-it

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MAJ - Anëtarët e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të martën kanë shqyrtuar vendimin e qeverisë për kryetar dhe anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Në këtë komision u kërkua dokumentacion shtesë nga qeveria në lidhje me këtë çështje.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje!, Mimoza Kusari-Lila, ka kërkuar që të procedohet kjo çështje, por që fillimisht të dërgohet një kërkesë te zyra e kryeministrit për dokumentacion shtesë. "Nuk jam që vendimi të kthehet në qeveri, por ta bëjmë një kërkesë që të na jepet dokumentacion shtesë. Propozoj që të kërkojmë nga Zyra e Kryeministrit për plotësim dokumentacioni derisa ato të procedohen në seancë të Kuvendit", u shpreh ajo.

Kurse kryetari i Komisionit dhe deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se këtë çështje e definon ligji qartë dhe se është mirë që mos të miratohet diçka me vërejtje. "Dua të shoh a kanë probleme me ligjin, konflikt interesi dhe punë të tjera", ka thënë ai.

Ndërkaq deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka kërkuar që ky vendim të kthehet në qeveri, duke kërkuar sqarime shtesë nëse ka pasur konkurs publik dhe janë ndjekur të gjitha procedurat. "E parasheh ligji dhe ata janë të emëruar nga qeveria" është përgjigjur deputeti Shala.

Por Lekaj sërish e ka marrë fjalën. "Po e citoj ministrin Hekuran Murati, i cili pati kërkuar që të ketë konkurs publik dhe ka kërkuar që të kthehet prapa. Çfarë ka ndryshuar tani", ka thënë Lekaj.

Kurse kryetari Shala ka thënë që së paku dy prej kandidatëve e meritojnë të jenë pjesë e bordit. "Tani janë në pozitë, atëherë kanë qenë në opozitë", ka komentuar Shala.

Kurse deputetja Kusari-Lila ka kërkuar që brenda javës të plotësohet dokumentacioni dhe të verifikohet e pastaj të procedohet për në Kuvend.



# Presteshi: S'kishte shkelje në çmimin e medikamentit Remdesevir

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MAJ - Anëtarët e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të martën kanë ngritur si shqetësim çmimet e larta të barnave për trajtimin e Covid-19. Ata kanë kërkuar sqarime nga kryetari i bordit i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, lidhur me çmimet e barnave si Remdeseviri etj.

Deputetët nga LV-ja, Jeta Statovci dhe Driton Hyseni, kanë kërkuar përgjigje nga Prestreshi për ankesat e shumta rreth çmimit të medikamentit Remdesivir. "Nëse ju dilni publikisht deklaroni se po nisni hetime ndaj medikamentit Remdesivir, keni atakuar hetimin", ka thënë deputeti Hyseni.

Mirëpo, sipas Prestreshit, Remdesiviri ka pasur një bujë mediatike por që, sipas tij, kur kanë nisur hetimet në treg, nuk kanë hasur në ndonjë shkelje. "Ka qenë një reagim, por në asnjë formë nuk ka çrregullim. Në hulumtimin tonë kemi hasur që nuk ka ndonjë marrëveshje apo ndonjë keqpërdorim në këtë drejtim", u shpreh ai.

Prestreshi ka folur edhe për ankesat e shumta të konsumatorëve për KEDS-in. Kreu i AKK-së ka bërë me dije se është duke u hetuar KEDS-KESCO për pronat publike në rastin e investimeve dhe në vendosjen e trafostacioneve.



# Vdes kompozitori Fahri Beqiri

PRISHTINË, 18 MAJ (ER) - Është ndarë nga jeta, në moshën 85 vjeçe, kompozitori i madh shqiptar Fahri Beqiri. Ai ishte edhe autori i veprave të mëdha muzikore, profesori që edukoi breza të tërë studentësh në Fakultetin e Muzikës në Prishtinë, mjeshtri i madh e i papërsëritshëm që ngriti në nivele artistike formacione e grupe të reja muzikore, zëra të rinj dhe festivale të munguara gjithandej nëpër Kosovë.
Këngëtari Ilir Shaqiri përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se të martën arti muzikor ka ulur flamurin në gjysmështizë. "U shua artisti, që çdo qelizë të trupit të tij, të mendjes së tij, të zemrës së tij e vuri në shërbim të së djeshmes së zorshme shpresëmbjellëse, duke vënë themele të qëndrueshme, modele të spikatura për brezat e ardhshëm sesi duhet punuar zellshëm e me profesionalizëm, seriozitet e ndjenja, duke veshur kulturën tonë burimore me kostumin muzikor më të bukur të kohës", ka shkruar Shaqiri.



# Restaurohen veprat 'Qëndresa' dhe 'Kullat e Qëndresës' në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit



PRIZREN, 18 MAJ (ER) - Me rastin e 18 majit, shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, në bashkëpunim me Autostradën Biennale, ka ndërmarrë iniciativën për restaurimin e dy veprave të artit (tapicerive) të autores Valbona Zherka, pjesë e ekspozitës së përhershme në sektorin e Galerisë së Arteve në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Veprat e autores Valbona Zherka, "Qëndresa" dhe "Kullat e Qëndresës", të punuara me teknikën thurje klasike e leshit, ishin në gjendje jo të mirë dhe mjaft të dëmtuara, andaj kanë pasur nevojë imediate për trajtim urgjent.
Artistja Valbona Zherka, që njëherësh është edhe autore, do t'i restaurojë këto dy vepra dhe të njëjtat, pas restaurimit dhe dokumentimit të këtij procesi, do të rikthehen për ekspozim në ambientet e Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Kjo nismë vjen si rezultat i zbatimit të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar ditë më parë nga drejtori i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, Samir Hoxha, si dhe drejtuesi i Autostradës Biennale Leutrim Fishekqiu.
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren ka falënderuar Autostradën Biennale, me theks të veçantë Vatra Abrashi, e cila mori iniciativë për ta ndërmjetësuar restaurimin e këtyre dy veprave me vlerë të veçantë dhe të çmuar për institucionin tonë.

# Në Podujevë mbahet sesion informues për gratë ndërmarrëse

PODUJEVË, 18 MAJ (ER) - Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Komunës së Podujevës, Fondacioni HELP dhe Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), kanë mbajtur një sesion informues rreth lansimit të komponentës së fundit të Programit Gratë Ndërmarrëse në Energji (WEE), që ofron grante për bizneset mikro dhe bizneset fillestare "start-up" në pronësi të grave.
Bleta Abdulai, eksperte në MFK, i informoi të pranishmet se kush mund të aplikojë për këtë grant: Bizneset mikro dhe ato fillestare "start-up" në pronësi të grave që duan ta rritin biznesin e tyre me teknologji më eficiente të energjisë dhe/ose masa të kursimit të energjisë duhet të jenë të paktën 51 për qind në pronësi të grave, më pak se pesë të punësuar. Bizneset fillestare "start-up" që janë duke punuar por nuk janë regjistruar ende, i inkurajojmë shumë që të aplikojnë. Ato biznese të cilave u jepen grante do të duhet ta përfundojnë regjistrimin e biznesit të tyre si pjesë e kushtit të grantit para verifikimit të projektit, përndryshe granti duhet të kthehet në MFK, u tha gjatë sesionit.
Mbështetja maksimale në këtë program mund të jetë deri në 3 000 euro. Në këtë sesion ishte i pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Pajtim Balaj.



# Drejtori i Bujqësisë në Ferizaj vizitoi fermerët kultivues të perimeve



FERIZAJ, 18 MAJ (ER) - Drejtori i Bujqësisë në Ferizaj, Burim Bajrami, ka vizituar fermerët kultivues të perimeve. Gjatë kësaj vizite ai është ndarë i kënaqur me punën dhe rezultatet e subvencionimit të këtij sektori. Bajrami ka thënë se mbështetja për bujqit e fermerët ferizajas nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pylltarisë po realizohet në zhvillim të ekonomive familjare dhe fuqizim të këtij sektori në Komunën e Ferizajt. "Të tillë janë edhe kultivuesit e perimeve në serra dhe jashtë saj. Pamë nga afër ecurinë e punës të këtij viti si dhe funksionimin, përdorimin e pajisjeve të cilët fermerët përfituan përmes thirrjes publike të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë. Mbështetja për fermerët do të jetë e vazhdueshme për ta fuqizuar akoma më shumë këtë sektor, porse edhe do të shumëfishohet mbështetja në këtë drejtim, në dobi të fermerëve ferizajas", ka thënë Bahrami.

# MEHMET MALAJ BABAI I HEROIT TË KOMBIT REXHEP MALAJ



Ismet SYLEJMANI

Më 18 Maj 2021, mbushen 23 vite, prej kur zemra e madhe e Axhës Mehmet Malaj, e ndali punën e saj!
Më 18 Maj 1998, ishte dita e fundit ndonëse i pajetë, që ishte në mesin e njerezve më të dashur të Tij, ishte në mesin tonë, Babai trim, Babai i pamposhtur, Babai zemërgurë, Babai i luftetarit më të madh të popullit, Kombit e Atdheut, Heroit te Kombit Rexhep Malaj, Axha Mehmet Malaj!
18 Maji i vitit 1998 shënon ditën kur populli shqiptar i Gjilanit me rrethinë dhe i tërë Kosovës, morri pjesë në mënyrë masive në varrimin e njërit prej baballarëve më të mëdhenj të heronjëve të kombit!
Më 18 Maj 1998 në përcjelljen për në varr të Axhës Mehmet Malaj në Gjilan ndodhi ajo që kushdo që e ka dashur Atdheun e Kombin, kushdo që ka bërë lëvizjen më të vogel dhe ka shfaqur dëshiren më të pakët për ta parë popullin shqiptar pa shtypje e shfrytezim të lirë e pa pushtues, është bindur përfundimisht se populli ta shpërblen mundin dhe djersën, gjakun dhe luftën, perpjekjet dhe qëndresën!
Gjilani më 18 Maj 1998 kishte ditë dhembje!
Mehmet Malaj Babai i i Heroit te Kombit Rexhep Malaj, do te varrosej dhe do ti jepej lamtumira e fundit!
Rruga nga shtëpia e Heroit të Kombit Rexhep Malaj, ku kishte jetuar e qëndruar plaku i pamposhtur e stoik Mehmet Malaj e deri te varrezat ku do te futej në varr e do të mbulohej pergjithmonë me dheun e varrit të djalit të tij që nuk e lejuan të varrosej në atë varr afër me Heroin e Kombit Nuhi Berisha, ishte rruga që peshonte më së shumti me popull, ishte rruga që ishte mbushur me plot njerëz, ishte rruga pasqyrë ku shihej në të palca e dashurisë së popullit që ushqente për liridashësin, ishte rruga që tregonte se kush është në rrugën e drejtë por të vështirë të çlirimit të Atdheut, në rrugë e sheshe nderohet e në rrugë i jepet lamtumira lavdimadhe, edhe në rrugë i shprehet në mënyrë masive dashuria, edhe në rrugë i bëhet nderimi madhështor, edhe në rrugë i tregohet pushtuesit dhe tradhëtarëve, se vdekja e Babait të Heroit të Kombit Rexhep Malaj, është dhembje për secilin, është dhembje për çdo gjë që është shqiptare, për të gjithë që ia dijnë vlerën burrërisë e dashurisë së papërshkruar për vendin e të parëve, për lirinë e të cilit, gatishmëria për flijim është e njëqind për qind(100%-të)!
18 Maji i vitit 1998, popullin shqiptar në Gjilan e mban mend duke ecur kokulur nga dhembja por krenarë, duke ecur këmbë e i vendosur për të varrosur dhe ndahej përgjithmonë nga Babai i Heroit të Kombit Rexhep Malaj! Varrosej burri i madh dhe i pamposhtur Mehmet Malaj në kohë lufte!
Kishte filluar lufta heroike dhe titanike në Kosovë!
Në Drenicën Legjendare JASHARAJT heronj të gjithë në ballë me Komandantin Legjendar Adem Jashari ishin shkrirë për Atdhe!
Në Dukagjinin heroik, në Gllogjanin e pamposhtur iu kishte vënë zjarri i lirisë forcave ushtarako-policore të Serbisë pushtuese!
Për të nderuar këtë Baba të pashembullt, në mbrëmjen e 17 Majit 1998, veprimtari aktiv i çështjes kombëtare, ish-i burgosuri politik, luftëtari i lirisë e ushtari i UÇK-së, Kryetari i Kuvendit e Anëtari i Kryesisë së Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, Kryeredaktori i gazetës së studenteve “Bota e re”, gazetari legjendar i popullit shqiptar Muhamet Mavraj, merr vendim qe ta botojë para kohe numrin e gazetës “Bota e re” që të njoftonte per vdekjen e Babait te Heroit te Kombit Rexhep Malaj!
Axha Mehmet Malaj, pati një varrim të madh që do të mbahet mend pergjithmonë!
Historia do ta vendose ne mesin e varrimeve te rralla, sepse populli morri pjese ne menyre masive me gjithe pengesat nga pushtuesi!
Populli i bëri nderime të mëdha ndonëse ishte gjendje lufte!
Ushtria Çlirimtare e Kosovës në pjesë të ndryshme të fronteve të luftës, në ditën kur lëshohej në varr trupi i pajetë i Axhës Mehmet Malaj, luftonte ballë për ballë me ushtrinë dhe policinë e Serbisë pushtuese!
Ky Baba i madh e i lavdishëm, bashke edhe me shume baballare te tjere te medhenje, qe popullit, Atdheut e Kombit ia kane falur bijat e bijte me te mire, jane e do te jene te pavdekshem!
Lavdi e perjetshme Axhes Mehmet Malaj!

**Prishtinë, 18 Maj 2021**



**Me rastin e vdekjes së patriotit Mehmet Malajt**

Mehmet Malaj

Më 18.05.1998 në Gjilan ndërroi jetë plaku i urtë e bujar, Mehmet Malaj. Ai ishte njëri ndër baballarët e rrallë që popullit dhe atdheut, i fali njërin ndër luftëtarët më të mëdhenj e më të devotshëm të çështjes kombëtare, të pathyeshmin, të patremburin dhe të papërkulurin, ilegalin e orëve të para, politikanin revolucionar e të pakompromis, autorin e kujtimeve nga burgu me titull "Sy më sy me bandën titiste, i paarmatosur, por fitimtar me drejtësinë zemër", ish-të burgosurin politik, dëshmorin Rexhep Malaj.
Mbi supet e Axhës Mehmet, për vite të tëra kanë rënduar halle e derte, poshtërsi e fyerje, tortura e provokacione nga më të ndryshmet, që ka ditur t'i bëjë ajo shtresë puthadorësh të sojit të Broshëve, Morinëve etj.
Përballë sfidave dhe provokacioneve të armikut, Axha Mehmet, kurrë nuk është dorëzuar, kurrë nuk është thyer e gjunjëzuar, as atëherë kur ia kanë vrarë zemërmadhin syzjarr, trimin Rexhep Malaj, as atëherë kur nuk ia kanë lejuar vënien e kurorës mbi varr të Rexhepit, të cilën Hanifja, gruaja e dëshmorit, e ruan qe plot 14 vjet në shtëpi.
Shumë herë e kishin zgjuar në orët e hershme të mëngjeseve këlyshët e UDB-së, që ia përmbysnin çdo gjë që i gjenin në shtëpi. Shumë duroi ky plak i panënshtruar, që ishte i nivelit të Shaban Jasharit, sepse djali i tij, Rexhepi, së bashku me Nuhiun, që më 1984 në Prishtinën e Kuqe, thirrjeve dhe krrokamave të telallëve të UDB-së për t'u dorëzuar, iu përgjigj me flakë të pushkës së lirisë.
Ushtima e krismave të armëve të UÇK-së, është përcjellja më madhore që do të mund t'i bëhej atij që luftës për liri i dha një luftëtar çfarë ishte i madhi Rexhep Malaj.
I qoftë i lehtë dheu të cilin e skuqi me gjak Rexhep Malaj!






Sport




# Thaqi: E kisha obligim moral ta inkuadroja Malishevën në Superligë

Arsim Thaqi është i lumtur që ka arritur një synim të madh në karrierë, duke e inkuadruar për herë të parë në rangun elitar klubin nga vendlindja e tij, Malishevën. "Duke e ditur se jam nga ky regjion ka qenë një zgjedhje emocionale e imja që ta marrë drejtimin e Malishevës. Nuk ka qenë e lehtë marrja e kësaj detyre për faktin se mospërmbushja e objektivit do të ishte një dështim për mua si trajner. Kishte zëra se nuk kam qenë i interesuar ta drejtoj këtë klub, por i demantova të gjithë dhe e kreva obligimin moral që ta siguroj Superligën", ka thënë Thaqi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 MAJ - Trajneri Arsim Thaqi ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm duke e inkuadruar për herë të parë skuadrën e Malishevës në Superligën e Kosovës në futboll. Trajneri Thaqi të martën për "Epokën e re" ka thënë se ishte obligim moral i tij që këtë klub ta inkuadrojë në elitë pasi vjen nga ky regjion. "Duke e ditur se jam nga ky regjion ka qenë një zgjedhje emocionale e imja që ta marrë drejtimin e Malishevës. Nuk ka qenë e lehtë marrja e kësaj detyre për faktin se mospërmbushja e objektivit do të ishte një dështim për mua si trajner. Kishte zëra se nuk kam qenë i interesuar ta drejtoj këtë klub, por i demantova të gjithë dhe e kreva obligimin moral që ta siguroj Superligën", ka thënë Thaqi. "Suksesi është historik, por rruga ka qenë e vështirë, sepse klubi nuk ka pasur përvojën e duhur. Për sukses janë të gjithë meritorë dhe e falënderoj gjithsecilin", ka shtuar Thaqi.

Trajneri me përvojë të madhe ka thënë se ende nuk ka vendosur se a do të jetë në krye të këtij klubi edhe në rangun elitar, pasi marrëveshja ka qenë vetëm për gjashtë muaj. "Ende nuk kam vendosur se a do të jem në krye të klubit. Deri tash ka qenë zgjedhje emocionale, kurse tash e tutje duhet të jetë profesionale. Kontratë kam pasur vetëm për këta gjashtë muaj dhe jam krenar që kam arritur këtë sukses historik. Duhet të ulemi të bisedojmë dhe ta analizojmë situatën, pastaj të marrim një vendim që do të jetë i mirë, në rend të parë për klubin", ka deklaruar Thaqi. Ky është suksesi i tretë i trajnerit Arsim Thaqi në karrierën si trajner, derisa i dyti i këtij lloji. "Suksesi me Malishevën është mjaft i veçantë, por i tillë është edhe ai me 2 Korrikun ku për tri vjet nga Liga e Dytë kemi arritur të inkuadrohem në Superligë. Një tjetër sukses për mua si trajner ishte drejtimi i Prishtinës në Ligën e Evropës", ka shtuar ai.

Në fund trajneri Thaqi ka thënë se Malisheva ka potencial për Superligë dhe se i duhen disa ndryshime të vogla për të qenë një skuadër konkurruese me skuadrat e tjera të këtij rangu. Skuadra e Malishevës është themeluar në vitin 2016, kurse brenda pesë vjetësh ka arritur sukses të jashtëzakonshëm duke u shpallur kampione e Ligës së Parë, njëherësh duke e siguruar pjesëmarrjen në Superligë.

# Kosova në vend të Kazakistanit dhe Komorosit luan me Maltën dhe Guinenë



PRISHTINË, 18 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se për shkak që Qeveria e Kazakistanit nuk e ka lejuar kombëtaren e këtij vendi të udhëtojë në Kosovë, ndeshja miqësore e paraparë për t'u zhvilluar më 4 qershor në Prishtinë, Kosovë - Kazakistan, është anuluar, derisa në këtë datë "dardanët" do të luajnë miqësore me Maltën në Austri. Miqësorja tjetër e paraparë për t'u zhvilluar në Antalia më 8 qershor kundër Komorosit do të zëvendësohet me Guinenë, pasi Komorosi, për shkak të restrikcioneve për hyrje në Turqi si pasojë e Covid-19, e ka të pamundur të udhëtojë në këtë datë në Antalia. "Dardanët" gjatë muajit qershor do t'i zhvillojnë katër miqësore. Fillimisht më 1 qershor do të përballen me San Marinon në stadiumin "Fadil Vokrri", më pas do të udhëtojnë në Austri për t'u përballur me Maltën (më 4 qershor), pastaj do të udhëtojnë në Antalia, ku do t'i zhvillojnë miqësoret me Guinenë dhe Gambinë, më 8 përkatësisht 11 qershor.

# Grumbullimi i parë i Kosovës

PRISHTINË, 18 MAJ - Është bërë grumbullimi i parë i Kosovës A në konkurrencën e femrave. Takimi ishte më shumë informativ dhe për ta parë formën e lojtareve. Përzgjedhësi i Kosovës A (F), Fidan Shatri, ka folur para basketbollisteve për rëndësinë që ka ky grumbullim, por edhe për formimin e Kosovës A dhe debutimin në garat ndërkombëtare. Kujtojmë se kjo



është hera e parë që Kosova A do të luajë në garat evropiane, përkatësisht në Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla, që do të mbahet nga 20 deri më 25 korrik në Qipro.

Edhe drejtori i përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova, ka thënë se lojtaret do të kenë trajtimin e njëjtë si Kosova A meshkujt dhe shpreson në paraqitje të mira të tyre gjatë garave ndërkombëtare. Kur grumbullimi do të vazhdojë në qershor, do të kompletohet ekipi me lojtare që luajnë jashtë Kosovës. Në stërvitjen e parë ishte një atmosferë e mirë sportive, me basketbollistet që ndihen krenare që po përfaqësojnë për herë të parë Kosovën A në garat evropiane. Ekipi i Kosovës përbëhet nga lojtare me përvojë, por edhe të talentuara nga të cilat pritet shumë në të ardhmen.

## Ndeshjet vendimtare të hendbollit zhvillohen në Istog

PRISHTINË, 18 MAJ - Në palestrën e qytetit në Istog do të luhen ndeshjet gjysmëfinale dhe finale të Kupës së Kosovës në të dyja konkurrencat. Orari i ndeshjeve tashmë është përcaktuar. Të premten janë gjysmëfinalet. Nga ora 13:00 takohen hendbollistet e Ferizajt dhe të Prishtinës. Gjysmëfinalja e parë e hendbollistëve në mes të Prishtinës e Kastriotit është nga ora 15:00. Nga ora 17:00 luhet gjysmëfinalja e dytë e hendbollistëve në mes të Trepçës dhe Besa Famgasit. Dita e gjysmëfinaleve mbyllet me sfidën e hendbollisteve: Vushtrria-Istogu. Ky takim është nga ora 19:00. Të shtunën finalja e hendbollisteve është nga ora 17:00, kurse finalja e hendbollistëve nga ora 19:15. Pas ndeshjes dramatike në mes të Istogut e Vushtrrisë, që përcaktoi kampionin te hendbollistet, pritet turne me ndeshje interesante edhe për Kupën e Republikës së Kosovës.



## Barça planifikon zëvendësimin e Koemanit me Flickun



BARCELONË, 18 MAJ - Humbjen 8-2 me Bayern Munichin te Barcelona nuk do ta harrojnë për shumë kohë. Në bankinë për bavarezët ishte Hansi Flick, i cili është larguar së fundmi dhe me shumë mundësi do ta drejtojë Gjermaninë. Ende nuk ka asgjë zyrtare edhe pse në Gjermani mediat e bëjnë të sigurt këtë lëvizje. Në Spanjë raportojnë se Barcelona është e interesuar t'ia besojë bankinën gjermanit Flick. Ronald Koeman konsiderohet i larguar në fund të sezonit dhe gazetari Gerard Romero raporton se Flick është një nga opsionet për Barcelonën, pasi ende nuk e ka mbyllur marrëveshjen me Federatën Gjermane të Futbollit. Sigurisht alternativa e Xavit është e pashmangshme. Legjenda e klubit spanjoll drejton aktualisht skuadrën e Al Sadd dhe ka arritur suksese të rëndësishme.

# Prishtina mëson dy kundërshtarët e mundshëm në Ligën e Kampionëve



PRISHTINË, 18 MAJ - Prishtina ka arritur që për herë të pestë që nga pranimi i Kosovës në UEFA ta sigurojë daljen në Evropë. Por, kjo do të jetë hera e parë që Prishtina do ta përfaqësojë vendin në Ligën më prestigjioze të futbollit evropian, Ligën e Kampionëve. Formati i këtij kompeticioni dallon nga ai i Ligës së Evropës ku skuadra e Superligës së Kosovës garoi për katër vjet rresht. Më 22 qershor në kryeqytetin e Ishujve Faroe, Torshavn, zhvillohen nga një ndeshje gjysmëfinale të raundit preliminar, kurse pas tre ditësh, më 25 qershor, zhvillohet finalja, fituesja e së cilës kualifikohet në raundin e parë. Shorti i raundit preliminar, aty nga ku Prishtina e nis misionin, hedhet më 8 qershor. Kurse i raundit të parë më 15 qershor dhe i raundit të dytë më 16 qershor. Skuadrat e kualifikuara deri më tani janë kampionët e Kosovës, Prishtina, e Ishujve Faroe e cila u shpall në vitin 2020, skuadra më e njohur e këtij vendi, HB Havnar Boltfelag nga Torshavn dhe ajo e Andorrës, Inter Club nga d'Escaldes. Ndërkohë, kampioni i San Marinos përcaktohet në duelin e tyre direkt këtë të shtunë ndërmjet La Fiorita dhe Folgore.
Prishtina asnjëherë nuk është ndeshur me këto skuadra, kurse me koeficient është bartëse së bashku me HB me nga 2 250 pikë, ndryshe nga Inter me 1 500. Po ashtu, koeficientin e ulët e kanë edhe skuadrat nga San Marino. Ndryshe nga edicionet e kaluara, tani me formimin e UEFA Conference League, eliminuesit e Ligës së Kampionëve në raundin preliminar dhe atë të parë vazhdojnë garat në Conference League, kurse nga raundi i dytë garat i vazhdojnë në UEFA Europa League. Ndërsa çdo skuadër e eliminuar nga Liga e Evropës, deri pas përfundimit të garave nëpër grupe, dhe në raundin kualifikues paraprak, vazhdon garat në Conference.

# Ronaldo: Haaland apo Mbappe? Vështirë të zgjedhësh



TORINO, 18 MAJ - Cristiano Ronaldo dhe Leo Messi ndan fronin për më shumë se dhjetë vjet në botën e futbollit. Këtë sezon, megjithatë, të dhënat e tyre të mira individuale po e mbyllin me zhgënjime në ekipet e tyre. Portugezi i Juves po kalon një kohë të keqe dhe mund të mbetet jashtë Ligës së Kampionëve pavarësisht prej kontributit të tij. Barcelona, megjithëse fitoi Kupën e Mbretit, mbeti pa titull fundjavën e kaluar, pa marrë parasysh se Messi është golashënuesi më i mirë në La Liga. Ndikimi i tyre nuk është më aq "brutal" dhe trashëgimtarët çdo ditë duken më afër vendit të nderit, që për vite dhe vite ishte i rezervuar vetëm dhe ekskluzivisht për ta. Tashmë po mbërrin "gjaku i ri", përfaqësuar nga dy eksponentë maksimalë: Erling Haaland dhe Kylian Mbappe. Cristiano Ronaldo foli për të dy në një deklaratë të dhënë për "Livescore", portal me të cilin sapo ka nënshkruar një kontratë të re sponsorizimi. "Është e vështirë të zgjedhësh vetëm një lojtar për të thënë se ai do të jetë më i miri, por është emocionuese të shohësh këtë brez të ri të të rinjve si Haaland dhe Mbappe", ka thënë ylli portugez. Për të arritur majat, si ai, CR7 tregon vetëm një rrugë përpjekjeje dhe sakrificë: "Disa janë të aftë të bëjnë një ose dy sezone të shkëlqyera, por vetëm më të mirët janë ata që qëndrojnë në majë sezon pas sezoni. Kjo nuk është aq e lehtë. Duhet punë dhe shumë përkushtim", ka deklaruar Ronaldo.

## SHKURT

### Strakosha është synim i Southamptonit

Southamptoni është skuadra e interesuar për portierin e Lazios, Thomas Strakosha, i cili mund të transferohet në Angli. Portieri shqiptar ka luajtur vetëm shtatë ndeshje në Serinë A me "Biancocelesti" këtë sezon, pasi ai është zëvendësuar nga veterani Pepe Reina. "Tuttomercatoëeb" raporton se Lazio është e gatshme për t'i dëgjuar ofertat për të dhe 26-vjeçarin nga Shqipëria. Raportimi për interesimin e Southamptonit në portierin i cili u transferua në Lazio nga Panionios në vitin 2012 besohet se ka kohë që është shfaqur. Strakosha u promovua nga ekipi i të rinjve në vitin 2013 dhe që atëherë ka luajtur 175 lojëra konkurruese për Biancocelesti, duke mbajtur 50 porta të paprekura.

### Hodgsoni pas katër vjetësh largohet nga Crystal Palace

Klubi i Premierligës, Crystal Palace, i ka njoftuar tifozët e saj se Roy Hodgson do të largohet nga klubi në fund të këtij sezoni. "Pas katër vjetëve, duke menaxhuar këtë klub, do të largohet nga roli i trajnerit në fund të këtij sezoni", shkruhet në njoftimin e klubit. Në 36 xhiro në këtë sezon Crystal Palace ka grumbulluar 44 pikë dhe gjendet në pozitën e 13-të.

### Chelsea dhe Unitedi në garë për Calhanoglun

AC Milan po mendon rinovimin e kontratës me futbollistin turk Hakan Calhanoglu. Bisedimet mes drejtuesve të klubit kuqezi dhe menaxherëve të lojtarit vazhdojnë, por në rast se turku nuk pranon ta firmosë kontratën e re me "djallin", do të largohet në fund të sezonit me parametra zero, pasi në qershor i përfundon kontrata. Nga kjo situatë disi e ndërlikuar për italianët, kërkojnë të përfitojnë Chelsea dhe Manchester Unitedi që po monitorojnë me vëmendje çdo lëvizje që vjen nga kampi kuqezi.

### Guardiola paralajmëron ndryshime te City

Trajneri katalunas, Pep Guardiola, e ka pranuar se është e vështirë t'i mbash lojtarët të cilët janë të pakënaqur me pozitat e tyre për një kohë të gjatë. Guardiola ka lënë të kuptohet se do të ketë një ndryshim të skuadrës së Manchester Cityt këtë verë. City fitoi titullin e Premierë Ligës për herë të tretë dhe mund ta mbyllte një sezon të paharrueshëm me lavdinë e Ligës së Kampionëve. Bisedimet do të zhvillohen me lojtarët që mund të jenë të pakënaqur me pozitat e tyre.

## Benzema mund të ftohet nga Franca për Kampionatin Evropian

Ylli i Real Madridit, Karim Benzema, pas shumë viteve mund të ftohet për Kampionatin Evropianin 2020. Sulmuesi u pezullua nga Kombëtarja e Francës pas një skandali ndaj bashkëkombësit, derisa trajneri Didier Deschamps vendosi të mos e ftojë më asnjëherë. Sipas "L'Equipe", Deschamps është duke konsideruar ta ftojë Benzeman, që është duke kaluar në super formë te gjiganti spanjoll. Benzema është ndër qendërsulmuesit më të mirë në botë dhe me formën momentale tregon se është përforcimi i duhur për Francën para "Euro 2020". Ndërkohë, pas disa javëve do të bëhet zyrtare lista e Francës, ku ndoshta do të ketë befasi edhe pse Deschamps në konferencë për media kishte thënë se nuk është 'babagjyshi'.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:**

## KONKURS

**Për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Në bazë të Ligjit nr.05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Komisioni për Ndihmë Shtetërore është përgjegjës për këto detyra dhe përgjegjësi:

- vendos për autorizimin e ndihmës shtetërore;
- ofron komente me shkrim për projektligjet të cilat organet propozuese vlerësojnë se projektligjet kanë elemente të ndihmës shtetërore;
- vendos për përputhshmërinë e ndihmës shtetërore;
- urdhëron revokimin e ndihmës, në rast se vlerësohet se ndihma shtetërore nuk është në pajtim me dispozitat në fuqi për ndihmën shtetërore;
- propozon masa adekuate për të siguruar që çfarëdo skeme ekzistuese e ndihmës të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- autorizon përputhshmëritë e kushtëzuara të ndihmës shtetërore;
- Komisioni miraton Rregulloren e Punës, ku përcaktohet organizimi, procedurat administrative të vendimmarrjes si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit;
- Komisioni, çdo vit deri më 30 shtator miraton Raportin Vjetor të Ndihmës Shtetërore dhe ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Komisioni ushtron detyrat dhe përgjegjësitë tjera, të përcaktuara me Ligjin për Ndihmë Shtetërore.

**Mandati i anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore**

Anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, emërohen me mandat tri (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore, nuk duhet të mbajnë funksione publike dhe pozita të emëruara politike.

**Kandidatët për anëtarë të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, duhet të plotësojnë kushtet si vijon:**

- të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- të jenë të diplomuar në fakultetin ekonomik apo juridik, apo në fushat tjera përkatëse që lidhen me fushën e ndihmës shtetërore;
- të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale fushat e drejtësisë, financave publike ose fushat tjera që ndërlidhen me ndihmën shtetërore;
- të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burg për më shumë se gjashtë (6 muaj);
- të kenë aftësi për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me vendoshmëri dhe përgjegjshmëri.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:**

- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- CV;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

**PROCEDURA E KONKURRIMIT**

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 02.06.2021, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

**Aplikacionet mund të merren në këto vende**:

*Forma e shtypur***:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
*Forma elektronike***:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Skupština Republike Kosovo raspisuje:**

## KONKURS

**O izboru dva (2) člana Komisije za državnu pomoć**

Shodno Zakonu br.05/L-100 o državnoj pomoći, članovi Komisije za državnu pomoć, imenuju se od Skupštine Republike Kosovo.

**Dužnosti i odgovornosti Komisije za državnu pomoć**

Komisija za državnu pomoć odgovorna je za sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Odlučuje o ovlašćenju državne pomoći;
- Pruža pismene komentare na Nacrte zakona koje organi predlagači smatranju da isti imaju elemente državne pomoći;
- Odlučuje o usklađenosti državne pomoći;
- Naređuje ukidanje pomoći u slučaju ako se proceni da državna pomoć nije u skladu sa odredbama na snazi o državnoj pomoći;
- Predlaže adekvatne mere kako bi se obezbedilo da bilo koja postojeća šema pomoći bude u saglasnosti sa odredbama ovog zakona;
- Ovlašćuje uslovljene usklađenosti državne pomoći;
- Komisija usvaja Poslovnik, gde se određuje organizacija, upravni postupci odlučivanja kao i prikladne mere za izbegavanje sukoba interesa;
- Komisija, svake godine do 30. septembra usvaja godišnji izveštaj državne pomoći i isti prosleđuje Skupštini Republike Kosovo;
- Komisija vrši ostale dužnosti i obaveze određene Zakonom o državnoj pomoći.

**Mandat članova Komisije za državnu pomoć**

Članovi Komisije za državnu pomoć, imenuju se sa mandatom od tri (3) godine, sa mogućnošću ponovnog izbora za još jedan mandat. Članovi komisije za državnu pomoć, ne smeju držati javne funkcije niti političko imenovane pozicije.

**Kandidati za članove komisije za državnu pomoć, trebaju ispuniti sledeće uslove:**

- Da su državljanin Republike Kosovo;
- Da su diplomirali na ekonomskom ili pravnom fakultetu, ili ostalim relevantnim oblastima koje se nadovezuju sa oblašću državne pomoći;
- Da imaju najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblastima pravosuđa, javnim finansijama ili ostalim oblastima koje se nadovezuju sa državnom pomoći;
- Da nisu pravosnažno osuđeni na kaznu zatvora više od šest (6) meseci;
- Da imaju sposobnosti za vršenje dužnosti nepristrano, svesno, odlučno i odgovorno.

**Priloženo aplikaciji trebaju biti i sledeći dokumenti:**

- Dokaz državljanstva Republike Kosovo;
- Dokaz školske i stručne pripreme;
- Motivaciono pismo;
- CV- Biografija;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nisu osuđeni za krivično delo.

**PROCEDURA KONKURISANJA**

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 02.06.2021. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza" bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

**Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:**

*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul."Majka Tereza" bb. ili u
*Elektronskom obliku:* internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

## SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

| | |
|---|---|
| Country | Kosovo |
| Project Name | Threshold Program |
| Procurement Title | Procurement of Consultant Services Data Quality Review Consultancy |
| Procurement Ref. Number | RFP / MFK / QCBS / 2021 / No. 008 |
| Type of Procurement (goods, works or services as applicable) | Services |
| Employer | Millennium Foundation of Kosovo (MFK) |
| Publication Date | 18 May 2021 |
| Submission Deadline | 17 June 2021; 14:00 pm (Kosovo Time) |

The Millennium Foundation of Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the "Threshold Program agreement", and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for: Procurement of Consultant Services Data Quality Review Consultancy.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites proposals from eligible Consultants for Procurement of Consultant Services Data Quality Review Consultancy, the selected The Consultant shall perform an independent review of indicators, data, data sets, and data sources which are included in the M&E Plan and planned to be collected for threshold M&E activities. The Consultant's work will be for a period of approximately nine (9) calendar months, from the effective start date of the contract. Based on the DQR findings and recommendations, MFK and the IEs for the Threshold will produce action plans on how they are going to incorporate the findings.

This SPN follows the General Procurement Notice that appeared in dgMarket on 03 February 2021, UNDB Online on 03 February 2021, the MCA Entity's website millenniumkosovo.org on 03 February 2021, and local newspapers "Koha Ditore" and " Epoka e re" on 04 February 2021.

through the QCBS procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A Pre-Proposal Conference will be held at 16:00 (Kosovo time) on 27 May 2021 ONLY through online Zoom Meeting. Attendance is strongly advised for all prospective Consultants or their representatives but is not mandatory.

Zoom Meeting Link: https://us02web.zoom.us/j/86725442395

A complete set of Request for Request for Proposal (RFP) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RCQ document shall be published at the latest 5 days before the submission deadline on the link provided below): https://millenniumkosovo.org/procurment/procurement-of-consultant-services-data-quality-review-consultancy-rfp-mfk-qcbs-2021-no-008

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFP to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in proposal rejection. The File link for submission of proposals is included in the RFP document. Proposals shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFP documents no later than 17 June 2021 at 14:00 pm (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.
Proposals will be publicly opened in the presence of the bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend at the link: https://us02web.zoom.us/j/89948859539 on 17 June 2021 at 14:30 pm (Kosovo Time).

Contact Information:

| | |
|---|---|
| The address referred to above is: | Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo |
| Attn: | Arton Çitaku<br>MFK Procurement Manager<br>Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo |
| Tel: | 00 383 38 752 110 |
| E-mail: | procurement@millenniumkosovo.org |
| Website: | https://millenniumkosovo.org |

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

## NOTICE OF A CANCELLATION

Date: 18.05.2021

Procurement activity name: **Selection of an individual consultant for Judicial and Open Data Consultant (short-term)**
Procurement activity no.: **IC/ MFK/2020/017**
Procurement Method: Individual Consultant

Millennium Foundation of Kosovo hereby informs that the Procurement activity referenced above
canceled, due to the MFK decision.

**Note:** Any candidates who has any objection to the results and wishes to Challenge the decision, may submit a claim (as per the provision of the MFK Kosovo Interim Bid Challenge System posted in website of MFK: http://millenniumkosovo.org/ within 5 business days from the date of Publication of this notice, without thereby incurring any liability.

For any information, please contact the Procurement Team at below address:
Millennium Foundation of Kosovo
Address: Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana Building, 9th floor) Postal Code:10000 Prishtina, Republic of Kosovo.
Email.: procurement@millenniumkosovo.org

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania " **LURA** " **L.L.C.** me seli në **Prishtinë**, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të unik: 810117954 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedures së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazette.

## OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka " **LURA** " **L.L.C.** u **Prishtin** doneo odluku da ugasi biznis po br. Registra: **810117954** I ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company " **LURA** " **L.L.C.** in **Prishtinë** has come to the decision to quit its business with registry: **810117954.** The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Hilmo Maksuti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren..

▶ Detart Grajçevci shpall të pavlefshme ID-kartelen e lëshuar nga Kolegji AAB, Prishtinë.

▶ Idriz Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - lX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.

▶ Ibrahim Kroni shpall të pavlefshme dëftesën e vitit lll shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275


Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.
5.99€
ISBN 978-9951-780-56-8
Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE
Mehmet Kraja
HËNA PREJ LETRE
(Drama, trilogji)
ARMAGEDONI


FATMIR LEKAJ
KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET
E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese
ARMAGEDONI
Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe për trajtimin e konflikteve, ndërkohë edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, kurse për studime postmagjistraturale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merret me veprimtari të kërkuesit të pavarur dhe të këshillëdhënies për çështjet e integrimit etj. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji.